VENDIM
Nr. 21, datë 4.3.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.166, DATË 16.12.2004 "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 75 pika 2 të Kushtetutës dhe të nenit 117 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr.166, datë 16.12.2004 "Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në nenin 8 pika 2, fjalët "2 zëvendëskryetarë" zëvendësohen me fjalën "zëvendëskryetarët".

2. Në nenin 20, pika 2 riformulohet si më poshtë:

"2. Si rregull, deputeti mund të jetë anëtar vetëm i një komisioni të përhershëm. Në respektim të raporteve shumicë parlamentare–opozitë, deputetë të caktuar mund të jenë anëtarë të jo më shumë se dy komisioneve të përhershme. Deputeti mund të marrë pjesë në mbledhjet e komisioneve të tjera, por pa të drejtë vote.".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)